



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

- **Për:** Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGjK)
- 
- **Nga:** Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës
- 
- **Datë:** 12 janar 2024
  - **Lënda:** RAPORT NARRATIV PËR PUNËN E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR PERIUDHËN 1 tetor – 31 dhjetor 2023
- 

Gjykata Supreme e Kosovës e ka përmbyllur tremujorin e katërt të punës me 511 lëndë të kryera dhe 214 të trashëguara në vitin 2024.

Gjatë kësaj periudhe janë pranuar 525 lëndë të reja, derisa gjithsej në punë kanë qenë 725 lëndë.

Numri më i madh i kërkesave të paraqitura përmes mjeteve të jashtëzakonshme juridike në Gjykatë Supreme edhe në këtë tremujor ishte;


kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë - PML 195 të pranuar dhe 196 të kryera

Revizione 165 të pranuar dhe 165 të kryera

Kërkesat për Rishqyrtim të Jashtëzakonshëm Administrativ - ARJ 71 të pranuar dhe 72 të kryera

### **Shkalla e efikasitetit në zgjidhje të lëndëve 97.33 për qind**

Numri i lëndëve të pranuar në raport me numrin e lëndëve të kryera, në këtë tre mujor, i kalkuluar në përqindje, jep këtë pasqyrë në grafikun:



1. Numri i lëndëve të pranuar dhe atyre të kryera

Ndërkaq, shkalla e efikasitetit në zgjidhje të lëndëve, e kalkuluar në përqindje, është 97.33 për qind, duke llogaritur numrin e lëndëve të pranuar dhe atyre të zgjidhura, gjatë periudhës raportuese.

**Lëndët e zgjidhura gjatë tremujorit të katërt të vitit 2023 përfshijnë;**

196 kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë – PML,

165 revizione - Rev,

72 kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm administrativ-ARJ,

34 kërkesa për zbutje të jashtëzakonshëm të dënimit - PZD,

12 ankesa administrative - AA

6 lëndë, civile të ndryshme - CN

11 revizione ekonomike - E.Rev.

3 revizione administrative - A.Rev.

4 kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë civile - CML

4 ankesa për paraburgime - PN.II

1 Administrative të ndryshme - AN

1 kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë kundërvajtje - KML

1 Ankesë penale për shkallën e tretë - PA

1 kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë administrative - AML

## Seancat e përgjithshme të Gjykatës Supreme

Në tremujorin e katërt, nën drejtimin e kryetarit të Gjykatës Supreme, Fejzullah Rexhepi është mbajtur një Seancë e Përgjithshme e të gjithë gjyqtarëve të gjykatës, përfshirë edhe gjyqtarët e Dhomës së Posaçme.

Në këtë seancë, janë miratuar tri Mendime Juridike:

- Mendimi Juridik për zbatimin e kontratës kolektive sektoriale lidhur me kërkesat e pagës së 13-të në sektorin e shëndetësisë
- Mendimi Juridik për shpërblimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesat në pagë për kualifikim shkollor dhe pagën jubilarë në Policinë e Kosovës si dhe
- Mendimi juridik lidhur me kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), për kompensim sipas inflacionit dhe periudha kohore në të cilën zbatohet Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë.



3. Seanca e Përgjithshme e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, 9 tetor 2023

## **Përmbledhjet e Gjykatës Supreme**

Në fund të vitit 2023, përkatësisht në ditën e III-të, të ‘Ditëve të Gjyqësorit’, të organizuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, janë promovuar dy Përmbledhje të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Përmbledhja “Vendime të përzgjedhura të Gjykatës Supreme të Kosovës”, e cila ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së vendimeve gjyqësore dhe lehtësimin e punës së gjyqtarëve në zgjidhjen e drejtë të rasteve gjyqësore, dhe

Përmbledhja “Përmbledhje nga Praktika e Gjykatës Supreme në çështje penale dhe civile”, e cila ofron zgjidhje për çështjet dhe dilemat e ndryshme me të cilat ballafaqohen gjyqtarët e instancave më të ulëta, si dhe udhëzon gjyqtarët se si të veprohet në situatat e ngjashme duke respektuar dhe aplikuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore dhe duke marr për bazë edhe praktikat dhe standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

## **Takimet e Asamblesë së kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve Mbikëqyrës**

Asambleja e Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës nën udhëheqjen e Kryesuesit të Asamblesë, njëherësh Kryetarit të Gjykatës Supreme, Fejzullah Rexhepi, ka mbajtur dy takime gjatë tremujorit të katërt, përkatësisht në datat 8 nëntor dhe 12 dhjetor 2023, për të diskutuar një varg çështjesh me rëndësi për mirë-funksionimin e gjyqësorit.

## **Vizitat në gjykata**

Edhe gjatë tremujorit të katërt të vitit 2023, kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, Fejzullah Rexhepi ka vazhduar vizitat nëpër gjykatat themelore dhe degët e tyre me qëllim të diskutimit të mbarëvajtjes së punës dhe sfidave të hasura në punën e gjyqtarëve, në zbatimin e Udhëzuesit për politikë ndëshkimore dhe në zbatimin e planeve strategjike të KGjK-së. Në këto takime kanë marrë pjesë edhe kryesuesi dhe anëtarë të Komisionit për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022 – 2025, si dhe Planit Strategjik për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar 2022 – 2024


- Vizitë në Gjykatën Themelore në Gjykatën Themelore në Mitrovicë – 13 tetor 2023
- Takim në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme - 1 nëntor 2023
- Vizitë në Gjykatën Themelore në Prishtinë - 1 nëntor 2023
- Vizitë në Gjykatën e Apelit - 1 nëntor 2023
- Vizitë në Gjykatën Komerciale - 1 nëntor 2023
- Vizitë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, dega në Graçanicë - 2 nëntor 2023
- Vizitë në Gjykatën Themelore në Gjilan, dega në Viti - 2 nëntor 2023
- Vizitë në Gjykatën Themelore në Ferizaj - 2 nëntor 2023
- Vizitë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, dega në Lipjan - 2 nëntor 2023
- Vizitë në Gjykatën Themelore në Gjilan - 2 nëntor 2023
- Vizitë në Gjykatën Themelore në Gjilan, dega në Novobërdë - 2 nëntor 2023
- Vizitë në Gjykatën Themelore Mitrovicë, dega në Vushtrri - 6 nëntor 2023

## **Puna e Komisionit Këshillëdhënës për Politikë Ndëshkimore**

Komisioni Konsultativ për Politikë Ndëshkimore, gjatë tremujorit të katërt ka mbajtur një takim si dhe një punëtori dy ditore, me mbështetjen e Ambasadës Amerikane në Prishtinë.

Komisioni është duke punuar në finalizimin e revidimit të Udhëzuesit për Politikë Ndëshkimore, pas ndryshimeve në Kodin Penal dhe në atë të Procedurës Penale.

## **Publikimi i vendimeve gjyqësore**

 <p><b>976</b> <b>VENDIME TË PUBLIKUARA</b> tremujori i katërt</p> <p><b>TETOR</b> 219 Aktgjykime dhe aktvendime të publikuara</p> <p><b>NENTOR</b> 258 Aktgjykime dhe aktvendime të publikuara</p> <p><b>DHJETOR</b> 499 Aktgjykime dhe aktvendime të publikuara</p>	<p>Gjykata Supreme gjatë tremujorit të katërt të vitit 2023, ka publikuar 976 aktgjykime dhe aktvendime, prej tyre 399 vendime të Gjykatës Supreme dhe 577 vendime të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.</p> <p>Gjatë muajit tetor janë publikuar 219 vendime</p> <p>Gjatë muajit nëntor janë publikuar 258 vendime</p> <p>Gjatë muajit dhjetor janë publikuar 499 vendime.</p>
---	---

**RAPORT PËR PUNËN NË GJYKATËN SUPREME TË KOSOVËS NË PRISHTINË  
PËR PERIUdhËN 1.10.2023 DERI MË 31.12.2023**

	Të pakryera	Të pranuar	Gjithsej në punë	Të kryera	Te pakryera
Ankesa penale për shkallën e tretë "PA"	1	0	1	1	0
Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë "PML"	58	195	253	196	57
Kërkesë për zbutje të dënimit "PZD"	6	32	38	34	4
Revizion "Rev" "Rev II"	99	165	264	165	99
Mbrojtje e ligjshmërisë "CML"	2	5	7	4	3

Përsëritje e procedurës civile “CPP”	0	0	0	0	0
Civile të ndryshme “CN”	0	16	16	6	10
Revizione ekonomike “E.Rev”	11	13	24	11	13
Mbrojtje e ligjshmërisë “EML”	0	0	0	0	0
Përsëritje e procedurës administrative “APP”	0	0	0	0	0
Mbrojtje e ligjshmerise administrative “AML	1	0	1	1	0
A.Rev.	0	3	3	3	0
ARJ	21	74	95	72	23
Ankesa administrative “AA”	0	15	15	12	3
Mbrojtje e ligjshmerise kundervajtje "KML"	0	1	1	1	0
Ankesa per paraburgime "PN.II"	0	4	4	4	0
Penale Ndhime Juridike Nderkombetare "PNJD"	0	0	0	0	0
Administrative të ndryshme "AN"	0	1	1	1	0
AC-AKP	1	1	2	0	2
Gjithsej	200	525	725	511	214